



**KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN E VETË
MJETIT MOTORIK "KASKO"**

Adresa :
Rr. Ukshin Hoti nr.19, Prishtinë
Tel/Fax 038/240 241

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN E VETË MJETIT MOTORRIK "KASKO"

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. TERMA TE PERGJITHSHEM

- a. "**Siguruesi**" nënkupton SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A në Kosovë, që lëshon këtë kontratë në cilësinë e shoqërisë siguruese.
- b. "**I Siguruari**" nënkupton personin fizik ose juridik, interesi i të cilit mbrohet nga sigurimi.
- c. "**Përfituesi**" nënkupton personin fizik ose juridik të përcaktuar në Policën e Sigurimit si përfitues i dëmshpërblimit me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.
- d. "**Perfaqësuesi**" nënkupton personin fizik ose juridik që ngarkohet me lidhjen dhe nënshkrimin e kontratës së sigurimit.
- e. "**Mjet motorik**" nënkupton një mjet që lëviz në tokë, por jo mbi shina, me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave. Mjete motorike do të quhen edhe rimorkiot ose gjysëm rimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës.
- f. "**Përdorues**" nënkupton personat që perdorin mjetin motorik të siguar, emrat e të cilëve janë të shënuar detyrimisht në kontratën e sigurimit dhe për të cilët është i vlefshëm mbulimi në rast sigurimi.
- g. "**Kontrata**" është lidhja e marrëveshjes midis Siguruesit dhe të Siguarit.
- h. "**Kushtet e Sigurimit**" nënkupton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës për sigurimin Kasko të mjeteve motorike të pranuar dhe nënshkruara nga palët.

2. OBJEKTI (RREZIKU) I SIGURIMIT

Siguruesi, ofron mbulim për të gjithë mjetet motorike, të klasifikuara si të tilla në aktet ligjore dhe nënligjore të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, lidhur me humbjen apo dëmtimin e plotë ose të pjesshëm të tyre, si rezultat i rreziqeve të parashikuara në këto kushte sigurimi, në përputhje me përcaktimet e bëra në policën e sigurimit kundrejt pagimit të primit të sigurimit sipas rreziqeve të siguruara nga i siguruari.

3. RREZIQET E SIGURUARA

3.1. Siguruesi, do të dëmshpërblejë të Siguarin deri në shumën e siguar të përcaktuar në policë dhe/ose pyetësorin e marrjes në sigurim të nënshkruar nga i siguruari, për humbjet, dëmtimet e plota ose të pjesshme në mjetin motorik të siguar, të shkaktuara nga rreziqet:

1. Dëmtimet aksidentale;

2. Thyerja e xhamave;
3. Zjarri, rrufeja, eksplozioni;
4. Katastrofat natyrore;
5. Vjedhja, tentativa per vjedhje, vjedhje me dhunë;
6. Dëmtimi ne parkim (pa autor);
7. Dëmtimi nga aktet keqdashëse dhe terroriste;
8. Sigurimi i mjetit motorik edhe për “Jashtë Vendit”, pra edhe për jashtë territorit të Republikës se Kosovës, mbulon ne sigurim të gjitha rreziqet e zgjedhura nga i siguruari brenda vendit.

Rreziqet e siguruara

3.1.1 DËMTIMI AKSIDENTAL (përplasja , përmbysja)

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik nga:

- a. **Përplasja me një objekt fiks ose të lëvizshëm.**
- b. **Dalja nga rruga apo Përmbysja e mjetit motorik.**

Siguruesi, në rastin e ndodhjes së aksidentit paguan dhe shpenzimet e transportit te mjetit dhe personave që gjenden në të, deri në vendmbërritjen e parë, të përcaktuar nga siguruari.

I siguruari detyrohet të sjellë raportin policor dhe të bejë foto të vendit te ngjarjes dhe mjetit të dëmtuar dhe t'i depozitojë ato tek siguruari, në të kundert siguruari gëzon të drejtën të çlirohet nga dëmshperblimi.

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet në mjetin motorik të siguar, si rezultat i konsumit normal, amortizimit të mjetit motorik, defekteve apo avarive të brendshme elektrike apo mekanike të mjetit.
- b. Dëmet e shkaktuara në mjetin motorik të siguar nga persona dhe shkaqe te paindentifikuar nga i siguruari dhe/ose organet shtetërore përkatëse.

3.1.2 THYERJA E XHAMAVE

Thyerja e xhamave: do të kuptohet që nga plasaritja deri tek thërrmimi i xhamave të përparmë, të pasëm, anësor, të tavaneve të lëvizshem si dhe xhamave të fenerëve të shkaktuar nga goditja e një objekti të lëvizshem.

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet e shkaktuara në mbulesat ose perdet mbrojtëse nga dielli.
- b. Dëmet në çdo xham tjetër që nuk përfshihet në katalogun e prodhimit, por që është vendosur në mjetin motorik.

3.1.3 ZJARRI, EKSPLOZIONI DHE RRUFEJA

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet e mjetit tuaj nga:

- a. **Zjarri dhe Eksplozioni** që vijnë nga faktorë të jashtëm dhe përfshijnë mjetin e siguruar.
- b. **Rrufeja mbi mjetin motorik.**

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim ne sigurim:

- a. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni, që vijnë nga shkaqe të brendshme të mjetit motorik.
- b. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni ku shkak ka qënë pirja e duhanit në mjetin motorik.
- c. Dëmet kur aksidenti nuk është njoftuar në polici apo në repartin zjarrfikës.
- d. Dëmet e shkaktuara nga zjarri ose eksplozioni ne mjetin motorrik të siguruar nga persona të pidentifikuar.

3.1.4 KATASTROFA NATYRORE

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet e mjetit tuaj shkaktuar nga:

Stuhia, breshëri, dëbora, tufani, përmbytja, vërshimi, kur katastrofa natyrore është e njohur dhe e deklaruar si e tillë nga autoritetet përkatëse shtetërore.

Siguruesi do të paguajë gjithashtu dhe dëmet e shkaktuara në mjetin motorrik të siguruar nga rënia e objekteve të ndryshme, që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore.

Siguruesi do të paguajë edhe dëmet në mjetin motorrik te siguruar shkaktuar nga përmbytja e garazhit si rezultat i çarjes së tubacioneve të ujrave, edhe në rast se nuk ka ndodhur katastrofë natyrore.

Stuhi - do të konsiderohet një çrregullim atmosferik me një lëvizje ajri me shpejtësi jo më të vogël se 17.2 m/s ose 62 km/orë e cila mund të shoqërohet me shira, dëborë ose reshje të tjera.

Breshër - do të konsiderohen reshjet që formohen nga pikat e shiut të ngrira si akull në ajër dhe që bien kokrra – kokrra zakonisht në verë.

Dëbora - do të konsiderohet reshja atmosferike e ngurtë që bie flokë - flokë nga retë në trajtë kristalesh të bardhë me formë dhe përmasa të ndryshme.

Tufani - do të konsiderohet era e vrullshme zakonisht me shi të madh, breshër a dëborë të dendur.

Përmbytje - do të konsiderohet dalja e ujit nga kufijtë normal të rrjedhjeve natyrale apo artificiale, të liqeneve, rezervuarëve duke kaluar bregun, ledhet, cektinat, digat dhe shpërndahet për shkak të rrymës së ujit me nivel të lartë si dhe vërshimi i ujit në rrugë për shkak të rreshjeve shumë të mëdha e të papritura.

Vërshimi - Dalja e ujit të një lumi a përroi jashtë shtratit të tij i cili derdhet me vrull e përmbyt vendin rreth e rrotull.

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet nga tërmeti dhe rrëshqitja e tokës.
- b. Dëmet e shkaktuara gjatë kalimit të lumenjve ose përrenjëve.
- c. Dëmet e shkaktuara gjatë kalimit të rrugëve të vërshuara nga uji apo reshjeve atmosferike të cilat mund të ishin parandaluar nga i siguruari.

3.1.5 VJEDHJA

Vjedhja: Do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në menyrë të fshehtë, nga një ose disa persona, i mjetit motorik të siguar (vjedhje totale) ose i pjesëve apo aksesoreve të tij (vjedhje e pjeshme) të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore (Prokuroria).

Tentativa për vjedhje: Do të konsiderohet çdo veprim që ka synuar vjedhjen e mjetit motorik të siguar ose të pjesëve të tij por që nuk ka arritur të kryhet, duke shkaktuar demë ndaj mjetit motorik. Këtu mbulohen vetëm dëmet e shkaktuara mjetit motorik si pasojë e tentativës për vjedhje të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore (Prokuroria).

Nese i siguruari apo perfituesi i kontrates se sigurimit Kasko, refuzon vendosjen e paisjes GPS te kerkuar nga siguruesi ose nese i siguruari provon heqjen, demtimin apo e nxjerrjen jashte funksionit te paisjes GPS nga i siguruari apo persona te autorizuar prej tij, siguruesi lirohet nga detyrimi i mbulimit te vjedhjes se mjetit dhe rezervon te drejten e anullimit te mbulimit te ketij rrisiku, duke nderprere kontraten e sigurimit Kasko ne menyre te plote ose te pjeshme (perjashton mbulimin rrezikut te vjedhjes)

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet nga vjedhja nëse ato janë kryer nga i Siguruari ose përdoruesit, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit.
- b. Dëmet nga vjedhja ose tentativë vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose çelësat e mbylljes janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij.
- c. Dëmet nga vjedhja e pjeshme me shkaqe të pashpjegueshme pa shënja e gjurmë të dukshme që vertetojnë se ka ndodhur vjedhja.
- d. Vjedhja e paisjeve/pjesëve: autoradio/display-monitor dhe njësitë përbërëse të saj, autoparlante, kapakët, gomat dhe disqet e gomave, targat e mjetit motorik, pasqyra të mjetit motorik, fenerët para dhe mbrapa, përveç vjedhjes totale të mjetit motorik të siguar.
- e. Në rastet kur ato janë kryer nga vetë i siguruari apo persona të tjerë të udhëzuar apo urdhëruar prej tij ose përdorues të tjerë.
- f. Siguruesi nuk do të shpërblejë vjedhjet e pjeshme nga punonjësit e shërbimit të ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit.
- g. Siguruesi nuk do të dëmshpërblejë në rastin e vjedhjes së automjetit në qoftë se i siguruari nuk i paraqet (dorezon) siguruesit dy çelësat origjinal të automjetit të vjedhur

- h. Siguruesi që ka paguar shpërblimin e dëmit ka të drejte të kërkojë kthimin e shumës të paguar nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit.
- i. Vjedhja e mjetit, kur mjetit të siguruar kundër vjedhjes, i hiqet apo dëmtohet nga i siguruari, drejtuesi i automjetit, apo servisi i riparimit, paisja GPS e instaluar nga siguruesi për identifikimin e vëndndodhjes së mjetit (për ta mbrojtur nga vjedhja), nëse siguruesi ka njoftuar të siguruarin për rinstalimin e paisjes GPS dhe i siguruari nuk ka pranuar riparimin apo ri-instalimin e paisjes GPS.
- j. Vjedhja e mjetit, kur për arsye të neglizhencës së të siguruarit, nuk është instaluar paisja GPS apo nuk është zëvendësuar paisja GPS jofunksionale (të dyja këto raste të dokumentuara nga siguruesi).

3.1.6 DEMENTIMI NE PARKIM

“**Dëmtimi në Parkim**” mbulon në sigurim dëmet që vijnë si rezultat i dëmtimit të mjetit motorik, vetëm në rastet kur ai ndodhet i parkuar ne një vend të caktuar dhe nuk mund te indentifikohet shkakitari i aksidentit.

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim:

- a. Dëmet e shkaktuara mjetit motorrik te parkuar si rezultat i neglizhencës për parkim të gabuar të të siguruarit apo të autorizuarve prej tij;
- b. Dëmet e shkaktuara ne mjetin motorik si rezultat i gabimeve apo neglizhencës së përfaqësuesve të parkingut privat, autolarjeve ose serviseve;
- c. I siguruari detyrohet të bëjë foto të vendit ngjarjes, mjetit të dëmtuar në momentin e ngjarjes ose konstatimit të ndodhjes së tij, ta raportojë rastin në polici dhe t’i depozitojë ato siguruesit në të kundërt siguruesi gëzon të drejtën të çlirohet nga dëmshperblimi.

3.1.7 AKTET KEQDASHESE

Sigurimi i mjetit motorrik nga rreziku i “**Akteve keqdashëse dhe terroriste**” e cila vjen nga veprimet keqdashëse ose akte terroriste mbi mjetin motorrik të siguruar, gjatë qëndrimit ose qarkullimit të tij.

Me “**akte keqdashëse**” do të kuptojmë dëmet e ndodhura në mjetin motorik nga veprime të kryera me vullnet të plotë në menyrë të qellimshme apo keqdashëse nga palë të treta pa miratimin, dijeninë dhe/ose pelqimin e të siguruarit të shoqëruar me fotografi të mjetit të dëmtuar në vendin e ngjarjes.

Me “**akte terroriste**” të njejtin kuptim që jep Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Mbulohen në sigurim dëmet e shkaktuara mjetit motorik të siguruar nga akte terroriste kur objekt i tyre nuk është vetë mjeti motorik apo personi i siguruar, vërtetuar nga organet kompetente shtetërore.

Mbulohen në sigurim dëmet indirekte të shkaktuara mjetit motorrik të siguruar nga akte terroriste që synojnë shkatërrimin e qëllimshëm të pronës apo pasurisë me zjarr, eksploziv apo me mjete tjera.

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim:

- a. Nuk mbulohen në sigurim dëmet e shkaktuara mjetit motorrik të siguruar nga vetë i siguruari apo persona të tjerë të udhëzuar apo urdhëruar prej tij.
- b. Nuk mbulohen në sigurim dëmet e shkaktuara në mjetin motorrik të siguruar si pasojë e akteve terroriste kur objekt i tyre është vetë mjeti i siguruar.

4. PËRJASHTIME TË PËRGJITHSHME ÇFARE NUK ESHTË E MBULUAR:

Siguruesi, nuk do të dëmshpërblejë, humbjet apo dëmtimet, që pëson mjeti motorrik, në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekt, janë shkaktuar, rrjedhin ose janë renduar gjatë, në ose nga:

- a. Dëmet e shkaktuara qëllimisht dhe/ose të udhëzuara nga personi i Siguruar.
- b. Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, invazionit, veprimeve të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta civile, turbullira civile, revolucione, lëvizje separatiste, kryengritja popullore, rebelimit, revolta, puçe, grushte shteti, eksode, trazirave, grevës, sabotimit.
- c. Dëmet që vijnë si rezultat i shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor, ndotjes radioaktive, rrezatimeve jonizuese, ndotjeve kimike.
- d. Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit.
- e. Dëmet që shkaktohen nga përdorues, emrat e cilëve nuk janë shënuar në kontratën e sigurimit apo që nuk kanë autorizim tek noteri para dates së ndodhjes së ngjarjes, që nenkupton janë të pasiguruar, përjashtuar familjaret e të siguruarit (rendi I-rë) bazuar në të dhenat e Certifikatës Familjare, për rastet kur të siguar janë përsone fizik.
- f. Dëmet që rezultojnë nga konsumi normal, defektet apo avaritë e brendshme elektrike apo mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit.
- g. Prerja apo Shpërthimi i gomave dhe dëmet që pasojnë.
- h. Dëmet në mjetin motorrik si rezultat i përdorimit të gomave jo-sezonale dhe sipas percaktimit me ligj.
- i. Dëmet në mjetin motorrik të siguruar në operacione të tilla si: shërbimi, riparimi, kontrolli, larja, parkimi, dorëzimi ose shitja.
- j. Dëmet e shkaktuara nga përdoruesit, të pa pajisur me patentë shoferi valid (apo patente shoferi me afat të skaduar, patente shoferi të konfiskuar, pezulluar apo sekuestruar nga organet kompetente) për drejtimin e mjetit edhe kur këta janë të shënuar në policën e sigurimit apo familjarë të të siguruarit.

- k. Dëmet e shkaktuara kur drejtuesi i mjetit ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit ose të drogës ose refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli.
- l. Dëmet e shkaktuara në mjet nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive, gërryese, ndezëse, jonizuese etj. Siguruesi do t'i paguajë këto dëme nëse është rënë dakort më parë duke paguar një prim shtesë.
- m. Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e rastit të sigurimit.
- n. Siguruesi nuk do të mbulojë zmadhimin e humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës të të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos thellohen ato. Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të bëra që nuk lejojnë që të zmadhohen dëmet ose humbjet.
- o. Dëmet e shkaktuara nga materialet apo kafshet që transportoheshin me këtë mjet;
- p. Dëmet e shkaktuara nga rimorkiot që i janë lidhur mjetit.
- q. Dëmet që shkaktohen nga manovrat kur mjeti shtyhet me forcën e krahut;
- r. Dëmet që shkaktohen kur mjeti kalon në shtigje rrugësh apo qarkullon në rrugë të pashtruara, të painventarizuara (hapësira jo për qarkullim mjetesh);
- s. Dëmet që janë shkaktuar me qëllim dhe/ose të udhëzuara nga i siguruari, nga kontraktuesi, nga personat që bashkëjetojnë me të siguruarin, nga të punësuarit e tij, nga personat që transporton, nga ata që janë të ngarkuar për të drejtuar, riparuar apo ruajtur mjetin.
- t. Dëmet e shkaktuara pjesëve të automjetit të cilat janë vendosur vetë nga i siguruari dhe nuk janë pjesë e automjeteve standarte të prodhuesit;
- u. Dëmet që pëson mjeti motorik si rezultat i pjesëmarrjes në gara perfshirë ato sportive të autorizuara apo të paautorizuara.
- v. Dëmet që zmadhohen artificialisht nga i siguruari për kalimin e vlerës së franshizes, me qëllim përfitimin e mbulimit në sigurim.
- w. Çfarëdo humbje apo dëmi që rrjedh si pasojë e shkeljes së besimit (mos kthimi i automjetit pronarit legjitim, vonesa e kthimit etj. e cila nuk mund të provohet me dokumentacion të organeve kompetente – prokurorisë dhe nëse automjeti nuk posedon sistemin GPS.
- x. Vjedhja e mjetit, kur mjetit të siguruar kundër vjedhjes, i hiqet apo dëmtohet nga i siguruari, drejtuesi i automjetit, apo servisi i riparimit, paisja GPS e instaluar nga siguruesi për identifikimin e vëndndodhjes së mjetit (për ta mbrojtur nga vjedhja), nëse siguruesi ka njoftuar të siguruarin për rinstalimin e paisjes GPS dhe i siguruari nuk ka pranuar riparimin apo rinstalimin e paisjes GPS. v.
- y. Vjedhja e mjetit, kur për arsye të neglizhencës së të siguruarit, nuk është instaluar paisja GPS apo nuk është zëvendësuar paisja GPS jofunkionale (të dyja këto raste të dokumentuara nga siguruesi).
- z. Dëmet që rezultojnë nga gjesendet që gjenden brenda mjetit dhe ku nga të njëjtat shkaktohet ndonjë dëmtim i brendshëm në të gjatë levizjes së mjetit apo i ndalur.

5. **Siguruesi**, nuk do të jetë përgjegjës për humbje të mjeteve, të cilat rezultojnë të vjedhura më parë jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

6. Në çdo kërkesë, padi ose procedurë tjetër gjyqësore, ku **Siguruesi**, deklaron se, sipas parashikimeve të mësipërme, humbja apo dëmtimi nuk mbulohet në sigurim, barra për të provuar që kjo humbje, shkatërrim, dëmtim apo përgjegjësi mbulohet, do t'i takojë të **Siguarit**.

SHTRIRJA TERRITORIALE

7. Mbulimi në sigurim, është i vlefshëm brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe jashtë saj kur kjo është kërkuar nga i siguruari.

Kërkohej detyrimisht që ngjarja e sigurimit të vërtetohet me dokumentin e organeve të policisë apo prokurorisë, të vëndit ku ka ndodhur ngjarja.

Mbulimi në sigurim jashtë territorit të Republikës së Kosovës përfshinë shtetet:

Zona 1.

- a. Shqipëri
- b. Maqedoni e Veriut
- c. Mal i Zi
- d. Bosnje e Hercegovinë
- e. Serbi

Zona 2:

- f. Shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe
- g. Zvicër
- h. Norvegji
- i. Turqi
- j. Rusi

7.1 Përfshihet mbulimi nga Vjedhja në Bullgari

SHUMA E SIGURUAR

8. Mjeti motorik, i treguar në policën e sigurimit, mbulohet në sigurim, për një shumë të siguar, e cila përcaktohet në marrëveshje midis **Siguruesit** dhe të **Siguarit**.

9. Shuma e siguar, mund të jetë e barabartë me vlerën e blerjes së mjetit motorik të ri, kur ky merret në sigurim në momentin e vënies në qarkullim për herë të parë, ose me vlerën e tregut.

10. Në rast se, të dy palët bien dakord, që shumica e siguruar të jetë më e vogël ose me e madhe se vlera e tregut të mjetit motorik, do të kemi nënsigurim dhe mbisigurim dhe do të zbatohen procedurat e seksionit “Nënsigurimi” dhe “Mbisigurimi”. Në asnjë rast dëmshpërblimi nuk do të jetë më i madh se sa vlera reale e tregut.

POLICA E SIGURIMIT

11. **Siguruesi**, i dorëzon të **Siguararit**, një dokument të firmosur nga ana e tij, **Policën e Sigurimit**, e cila vërteton, pranimin e **Kushteve të Përgjithshme** nga i **Siguarari** si dhe lidhjen e **Kontratës së Sigurimit**.

12. Polica e sigurimit, lëshohet në bazë të, kërkesës me shkrim të të **Siguararit** “Pyetesori”. **Siguruesi**, lëshon Policën e Sigurimit dhe përcakton primin e sigurimit, në bazë të njoftimeve dhe deklarimeve të bëra nga i **Siguarari ne** “Pyetesor”. Kërkesat, njoftimet dhe deklarimet e tjera të të **Siguararit**, i bashkëngjiten dhe janë pjesë e Policës së Sigurimit.

I Siguarari, është përgjegjës, lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të bëra prej tij.

13. **Siguruesi**, ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të të **Siguararit** dhe të kryejë inspektime për saktësime të dhënash.

14. Kur, Polica e Sigurimit, humbet ose dëmtohet, në masën që bëhet e pavlefshme, me kërkesën dhe shpenzimet e të **Siguararit**, **Siguruesi**, duhet të lëshojë një dublikatë të saj.

15. Kërkesa për Sigurim.

Kupton kërkesën e të **Siguararit** për sigurimin e mjetit të tij duke i dhënë përgjigje formularit standart të përgatitur nga **Siguruesi**. I **Siguarari** ose personi i autorizuar nga ai, nënshkruan së bashku me agjentin ose inspektorin e marrjes në sigurim kërkesën për sigurim dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e deklarimeve të bëra në të. Pas plotësimit të kërkesës për sigurim, i **Siguarari** nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të **Siguruesit**. Me shtim të rrezikut kuptohen rrethanat që janë thelbësore të cilat mund të influencojnë në vendimin e **Siguruesit** për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë. Në rast të moszbatimit të kushtit të mësipërm, **Siguruesi** çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit.

16. Natyra dhe Shtrirja.

Kontrata e sigurimit përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, natyrën dhe shtrirjen e mbulimeve si dhe ndryshimet e primeve që rezultojnë nga ndryshimi i faktorëve të rrezikut. Ajo nënshkruhet nga të dy palët, **Siguruesi** dhe i **Siguarari** ose personat e autorizuar prej tyre dhe lëshohet pas pagesës së primit të sigurimit, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe.

17. **Kalimi i të Drejtave.** Të drejtat dhe detyrat e të **Siguararit** në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të **Siguruesit**. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në kontratën e sigurimit. Në rast se i **Siguarari** vdes, mbulimi për mjetin e siguruar do të vazhdojë të aplikohet

për trashëgimtarët ligjorë ose përfaqësuesin zyrtar tek të cilët kalojnë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë për përdorimin e mjetit, deri në fund të periudhës së sigurimit.

PRIMI I SIGURIMIT

18. **Primi i sigurimit** është çmimi i kontratës së sigurimit. **Tarifa** e tij përcaktohet në bazë të llogaritjeve, sipas mbulimit të zgjedhur, klasifikimit dhe veçorive të mjetit motorrik dhe vendoset në kontratën e sigurimit.

19. **I Siguruari**, paguan primin e sigurimit në mënyrën dhe afatet e përcaktuara në Policën e Sigurimit sipas mbulimeve të cilat ka kërkuar të sigurohet.

20. Pagesa, do të quhet e kryer, në momentin e kalimit të shumës së caktuar për llogari të **Siguruesit**.

21. Nëse primi nuk paguhet në afat, mbulimi në sigurim pezullohet deri në orën 24.00 të ditës që **i Siguruari** paguan shumën që detyrohet. Polica (kontrata) e sigurimit në rast se nuk është paguar primi i sigurimit do të qëndrojë e pezulluar për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe pas kalimit të këtij afati ajo zgjidhet automatikisht pa pasur nevojë për njoftim, përveç në rast të marrveshjes ndryshe nga palët. I Siguruari në kete rast është i detyruar të paguajë Siguruesin për kostot/shpenzimet administrative në masën prej 10% të primit.

APLIKIMI I SISTEMIT BONUS - MALUS

22. Në rinovimet e kontratave për mjetet që kanë përfituar dëmshperblim nga sigurimi KASKO, do të aplikohet MALUS që nenkupton rritje të primit të sigurimit e cila do të jetë në masën 15 % të primit të llogaritur.

23. Në rinovimet e kontratave për mjetet që nuk janë përfshirë në aksidente, pra nuk kanë përfituar dëmshperblim sipas kontrates KASKO, do te aplikohet BONUS që nenkupton zbritje (ulje), ulje e cila do të jetë në masën 10% të primit të sigurimit.

PERIUDHA E SIGURIMIT

24. Kjo kontratë, vlen për dëmet që ndodhin gjatë periudhës së treguar në policën e sigurimit. Periudha e sigurimit, është njëvjeçare, përveç rasteve, kur në policën e sigurimit përcaktohet ndryshe.

25. Mbulimi në sigurim, fillon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë e fillimit dhe përfundon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë mbarimi të mbulimit në sigurim në Policën e Sigurimit.

26. Në rastet kur pagesa e primit të sigurimit është kryer më parë, **Pergjegjesia e Siguruesit**, fillon në momentin kohor të përcaktuar në policë, pavarësisht momentit të kryerjes së pagesës.

ZGJIDHJA DHE PËRFUNDIMI I POLICËS SË SIGURIMIT

27. Kontrata e sigurimit, është e pavlefshme, nëse vërtetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar ose ka pushuar së qeni para lidhjes së kontratës.

Siguruesi do të zgjidhë kontratën e sigurimit në qoftë se:

- a. Nuk është paguar kësti vijues i primit të sigurimit, ose primi i sigurimit për kontratat e rinovuara. Data e zgjidhjes do të jetë 15 ditë pas mbarimit të afatit të pagimit.
- b. Ka të dhëna për pasaktësi të informacionit të dhënë nga I Siguruari.

I Siguruari mund ta zgjidhë kontratën:

- c. Duke njoftuar 30 ditë përpara datën e zgjidhjes.
- d. Kur te siguruarit ose përdoruesit të mjetit motorik i është hequr dëshmia e aftësisë gjatë muajve të fundit.

28. Kontrata e sigurimit, perfundon:

- a. Nëse, rreziku i sigurimit (mjeti) pushon së qeni pas lidhjes së kontratës, kontrata e sigurimit zgjidhet dhe ka të drejtën e arketimit të primit, për të gjithë periudhën e sigurimit.
- b. Me shqyrtimin e kërkesës për dëmshpërblim, të paraqitur nga i **Siguruari**, **Siguruesi**, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit, duke i kthyer të **Siguararit** pjesën e primit, në përputhje me tabelën e kthimit te primit. **Siguruesi**, mund të zgjidhë kontratën (kontratat) për një ose disa mjete të të njëjtit të **Siguarar**. Ne do të llogarisim kthimin e primit si ne vijim:
Në muajin e parë pjesa që mbahet nga primi është 19%, pastaj në çdo muaj ndalesa do të shtohet me nga 10% deri ne muajin e 8 (tetë) kur edhe perfundon periudha e kthimit të mundshëm.
- c. Mbi bazën e tabelës së kthimit do të aplikohet edhe ndalesa e shpenzimit administrativ në masën prej 10% e primit të kthyer.

28.1 Kur pas lidhjes të kontratës te sigurimit pushon interesi pasuror i të siguararit (transferohet pronesia), kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur.

DETYRIME

29. I **Siguruari**, duhet të informojë me shkrim **Siguruesin**, për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrethanat, konsiderohen thelbësore, nëse i **Siguruari** është pyetur me shkrim nga **Siguruesi**, ose ato janë të një natyre të tillë, që mund të influencojnë në vendimin e **Siguruesit**, për të lidhur ose refuzuar kontratën, apo për kushtet që do të vendosë.

Siguruesi, ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit brenda 45 ditëve nga fillimi i saj, për shkak të pasaktësisë së informacionit të dhënë nga i **Siguruari**. Në këtë rast, i **Siguruari**, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e primit të sigurimit.

30. I **Siguruari**, pas lidhjes së Kontratës së Sigurimit, duhet të njoftojë me shkrim çdo ndryshim në mjetin motorik, që sjell si pasojë rritjen e rrezikut.

Siguruesi, ka të drejtë, nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit, ose të zgjidhë kontratën. Mosnjoftimi nga **i Siguruari**, sjellë si pasojë çlirimin e **Siguruesit** nga detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit.

31. I Siguruari, duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm, për të mbrojtur nga dëmtimet apo humbjet mjetin motorrik, duke e mbajtur në kushte të sigurta dhe eficiente.

DYSIGURIMI

32. Nëse i Siguruari kryen një tjetër sigurim (dysigurim) për mbulimin e rreziqeve në përputhje me këto Kushte të Përgjithshme, ai duhet t'i komunikojë **Siguruesit** të parë, emrin e siguruesit tjetër si edhe shumën e siguruar.

Në rast se, qëllimisht apo për shkak të neglizhencës, **i Siguruari**, nuk plotëson detyrimet sipas paragrafit të mësipërm, **Siguruesi**, ka të drejtë të zgjidhë **Policën e Sigurimit** dhe të mos kthejë primin.

33. Në rastin e dysigurimit, masa e dëmshpërblimit nga të dy kontratat, nuk mund të jetë më e madhe se vlera e humbjes duke zbritur pjesën e zbritshme.

Nëse **i Siguruari** kryen sigurime të tjera me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme dhe **Siguruesi** mban primin e sigurimit.

NËNSIGURIMI

34. Siguruesi dhe i Siguruari, mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorrik për një **shumë Sigurimi** më të vogël se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorrik të ri.

Në këtë rast, dëmshpërblimi që do të përfitojë **i Siguruari**, do të llogaritet duke shumëzuar vlerën e dëmit me koeficientin e nënsigurimit. Koeficienti i nënsigurimit, është raporti i shumës së siguruar kundrejt vlerës së tregut apo të blerjes së mjetit motorrik të ri.

35. Nënsigurimi do të zbatohet edhe nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguruar është më e ulët se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorrik të ri.

MBISIGURIMI

36. Nëse Shuma e Siguruar, është përcaktuar më e lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit mjet motorrik të ri, **Siguruesi dhe i Siguruari**, kanë të drejtë të bëjnë ndryshimet përkatëse në Policën e Sigurimit, duke zvogëluar si Shumën e Siguruar ashtu dhe Primin e Sigurimit.

37. Në çdo rast, kufiri i përgjegjësisë së **Siguruesit**, nuk do të jetë më i lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit tip mjet motorrik të ri, duke zbritur pjesën e zbritshme.

38. Nëse, **i Siguruari**, lidhë kontraten e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. **Siguruesi**, ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

RIVENDOSJA E SHUMËS SË SIGURUAR

39. Pas pagesës se çdo dëmi, shuma e siguruar do të rivendoset në vlerën e saj fillestare në rast se i siguruari paguan primin shtesë.

Ne rast se i siguruari nuk paguan primin shtesë pra nuk e rivendos shumën e siguruar, atëherë mjeti motorik qëndron i siguruar deri në fund të afatit të caktuar në policën e sigurimit Kasko për një "shumë të re sigurimi" e barabartë kjo me diferencën e shumës së sigurimit fillestar dhe vlerës së dëmshpërblimit, pra për një dëm të dytë, i siguruari do të dëmshpërblehet sipas shumës së re të sigurimit, pra me nënsigurim.

NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT DHE DËMSHPËRBLIMI

40. Është kusht parësor për përgjegjësinë e **Siguruesit**, që për çdo ngjarje që mund të jetë shkak për kërkesë për dëmshpërblim, **i Siguruari**, menjëherë duhet:

a. Të njoftojë **Siguruesin** dhe **Perfituesin**, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes. Një njoftim i tillë, do të konsiderohet i dhënë **Siguruesit**, nëse është dhënë brenda 48 orëve nga ndodhja e ngjarjes.

b. Në rastin e ndodhjes së aksidentit, **i Siguruari**, detyrohet menjëherë të njoftojë sipas rastit të sigurimit, Policinë e trafikut, Zjarrfikësat brenda një afati prej 24 orësh nga momenti i ndodhjes apo konstatimit të tij dhe të vërë në dispozicion të **Siguruesit**, vërtetimin e autoriteteve të lartpërmendura, lidhur me njoftimin e bërë.

c. Të plotësojë "Raportin Evropian të Aksidentit" në rastet kur përfshihen dy apo më shumë automjete me dëme të vogla, pa lëndime trupore, fotot e vendit të ngjarjes dhe mjeteve të përfshira në aksident t'ia paraqesë atë **Siguruesit**, të shoqëruar me të gjitha të dhënat identifikuese përkatëse të mjeteve motorrik, të dëmtuara, si dhe rrethanat përkatëse të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Formulari standart i njoftimit të rastit të sigurimit dhe kushteve të mësipërme, duhet të plotësohet me besnikëri dhe në afatet e mësipërme, pa shtrembërime të fakteve të rastit të sigurimit nga **i Siguruari**. Në rast të kundërt, **Siguruesi**, ka të drejtën, të çlirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit.

d. Të shmangë dhe minimizoj humbjet ose dëmtimet aq sa është e mundur.

41. **I Siguruari**, për dëmet në mjetin e siguruar, paraqet kërkesë për dëmshpërblim brenda afateve të parashikuara nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit të sigurimit nëpërmjet formularit standart.

42. **Siguruesi**, gëzon të drejtën të çlirohet nga detyrimet e tij për dëmshpërblim nëse:

- a. **i Siguruari**, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e tij;

- b. **i Siguruari**, perpiqet të paraqesë në mënyrë të shtrembër ose mashtruese faktet para **Siguruesit**, fakte të cila kanë rëndësi për mundësinë dhe/ose masën e dëmshpërblimit.

43. Siguruesi, ka të drejtë, të verifikojë rrethanat në të cilat ka ndodhur Rasti i Sigurimit, si dhe të kryejë ekspertizën e dëmit apo të humbjeve në mjetin motorrik të siguar, brenda 15 ditësh nga dita e njoftimit të ngjarjes së sigurimit. Gjatë kësaj periudhe, **i Siguruari**, është i detyruar të mbajë mjetin motorrik të dëmtuar në dispozicion të **Siguruesit**, pa e riparuar atë.

Siguruesi do të paguajë të **Siguararin**, **Perfituesin** ose trashëgimtarin ligjor të tij për dëmet në mjetin motorrik të siguar, deri ne limitin e përgjegjesisë, duke zbritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit, të pagesat drejtpërdrejt, ndërsa tek rastet e riparimit në servis, i siguruari do paguaj pjesmarrjen e demit në llogarinë e Siguruesit. Dëmet me vlerë më të vogël se franshiza, nuk paguhen.

44. Siguruesi, në varesi të dëmit, përcakton formën e dëmshpërblimit si mëposhtë:

- a. Riparim i mjetit të dëmtuar, në pikën e riparimit të autorizuar nga Siguruesi. Nëse mjete është nën garancinë e prodhuesit/koncesionarit, siguruesi merr përsiper garancinë e mjetit deri ne mbarimin e afatit të garancisë të përcaktuar nga prodhuesi/koncesionari.
- b. Pagesën e vlerës së dëmit (me para).
- c. Zëvendësim i mjetit të dëmtuar, me një mjet tjetër analog.

Dëmshpërblimi do të jetë deri në vlerën e dëmit të ndodhur dhe në asnjë rast dëmshpërblimi nuk mund të tejkalojë limitin maksimal të përgjegjesisë të përcaktuar në policën e sigurimit/pyetësorin, pasi është hequr dhe pjesa e zbritshme e përcaktuar në policën e sigurimit.

45. Siguruesi, do të paguajë për shpenzimet e transportit, e të ngarkim-shkarkimit nga vendi i ndodhjes së rastit të sigurimit (për mjetin që nuk vetlëviz), deri në vendmbërritjen e përcaktuar nga **Siguruesi**.

46. Siguruesi, mund të shtyjë kohën e pagesës:

- a. Për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të **Siguararit**, për të marrë pagesën.
- b. Në qoftë se janë filluar hetime penale në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të **Siguararit**.
- c. Për aq kohë sa **i Siguruari** nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga **Siguruesi**.

47. Kur vlera e dëmit është më e lartë se 80% e shumës së siguar, mjete motorrik do të konsiderohet dëm total.

48. Në rastin e vjedhjes totale, **SIGAL sh. a**, do të paguajë derin ne 50% të vlerës së dëmit, brenda një periudhe prej 90 ditësh nga dita e marrjes se njoftimit lidhur me ngjarjen e sigurimit dhe pjesën e mbetur të dëmshpërblimit me përfundimin e procedurave investiguese dhe penale.

49. Në rast se është bërë dëmshpërblimi deri në limitin e përgjegjësisë dhe mjeti gjendet, ai do të vihet në dispozicion të Siguruesit.

I Siguruari, ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer pagesën që i është bërë, në rast të kundërt, **Siguruesi**, përfiton pronësinë mbi mjetin.

50. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, do të zbatohet pjesa e zbritshme, pjesmarrja dhe (ose) franshiza. Masa e pjesës së zbritshme dhe franshizës, do aplikohet tek pagesat e drejtperdrejta, ndërsa pjesmarrja do llogaritet tek riparimi i mjetit në servis. Pra i siguruari pjesën e tij të pjesmarrjes fillimisht do e paguan në llogari të siguruesit, sipas faturës së leshuar nga siguruesi, pastaj automjeti do riparohet në servis. Për çdo rast dëmi, **Siguruesi**, do të zbresë nga shpërblimi i llogaritur, pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit në shumë absolute ose në përqindje tek pagesat e drejtperdrejta që i bëhen te siguruarit, apo do aplikoj pjesmarrjen në dëm sipas përqindjes që i takon te siguruarit, tek riparimi i mjetit në servis. **Siguruesi**, nuk do të paguajë dëme të veçanta, që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë në kontratën e sigurimit.

51. **Siguruesi**, i njofton Përfituesit shumën e përllogaritur të dëmshpërblimit. **Përfituesi**, me marrjen e njoftimit e udhëzon **Siguruesin**, për mënyrën dhe destinacionin e pagesës së shumës së dëmshpërblimit.

52. Ky sigurim, nuk do të dëmshpërblejë dëme, për të cilat Përfituesi/i Siguruari përfiton dëmshpërblim nën kontrata të tjera.

Bën përjashtim, pjesa e dëmit, që tejkalon shumën që do të ishte mbuluar nën kontratat e tjera, në rastin kur Polica e përcaktuar nga këto kushte sigurimi, të mos ishte në fuqi.

53. Në rast pagesë dëmshpërblimi, sipas kësaj police, **Siguruesi**, do të ketë të drejtë të përfitojë të drejtën e **Përfituesit/ të Siguarit**, për të kërkuar kthimin e shumës/ të drejtave pasurore, ose të çdo të drejte tjetër legale, ndaj çdo personi ose organizate.

I Siguruari, do të veprojë, me të gjitha mënyrat e duhura për të siguruar këto të drejta dhe nuk do të bëjë asnjë veprim për të paragjykuar këto të drejta.

54. Pas pagesës së dëmshpërblimit, mjeti motorrik, qëndron i siguruar deri në fund të afatit të caktuar në kontratë, për një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së sigurimit dhe dëmshpërblimit të paguar.

I Siguruari, mund të rivendosë, shumën e siguruar, kundrejt pagesës së primit shtesë të llogaritur nga **Siguruesi**.

55. Për cdo marreveshje që nuk zgjidhet me mirëkuptim, palët, do t'i drejtohen Gjykatës kompetente, ku është lëshuar Polica e Sigurimit.

56. Për gjithçka jo të parashikuar në këto kushte, do të aplikohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

57. KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi për aq sa ofron mbulim sigurimi nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

58. Pjesë përbërëse dhe të pandarë të Kontratës së Sigurimit KASKO janë: Polica e Sigurimit, Kushtet e Përgjithshme në tërësi, Formulari i Kërkesës për marrje në sigurim dhe çdo dokument tjetër që i bashkëlidhet.

I Siguruari deklaron se vetem pasi ka lexuar, kuptuar qëllimin, dhe ka rënë dakord me termat dhe kushtet e kësaj kontrate sigurimi, i pranon ato me forcën e ligjit dhe nënshkruan pa rezerva policën e sigurimit.